

# ELASTICITETI I KERKESES & OFERTES

## Java 4

Alban Asllani, MSc, PhD Cand.  
Universiteti AAB  
alban.asllani@universitetiaab.com

## Hyrje

- Javen e kaluar ne mesuam se si ndryshon kërkesa dhe oferta ne treg, dhe si vendoset cmimi ekuiliber dhe sasia ekuiliber ne treg.
- Ne mesuam se çka mund te ndikoj ne ndryshimin e kërkeses dhe ofertes ne treg dhe, duke sjellur nje ekuiliber te ri, apo nje disekuiliber ne treg.
- Ne kete ligjerate ne do te mesojme se sa do te ndryshoj kërkesa dhe oferta ne treg, dhe jo vetem se si ndryshon.

## Çka eshte Elasticiteti?

- Elasticiteti shpreh shkallen e reagimit te subjekteve ekonomike (firmat dhe konsumatorët) ndaj ndryshimit te kushteve ekonomike te tregut, sic jane:
  - Ndryshimit te cmimit te se mires
  - Ndryshimit ne te ardhurat e konsumatorit
  - Ndryshimet ne cmimet e produkteve plotesuese ose zevendesuese
  - Ndryshimin ne koston e prodhimit, etj
- Me fjale tjera, elasticiteti eshte matja e reagimit te kërkesës dhe ofertës ndaj ndryshimeve në çmime dhe gjëra të tjera

## Llojet e elasticitetit

### Kërkesa:

- Elasticiteti i kërkeses lidhur me çmimin
- Elasticiteti i kërkeses lidhur me te ardhurat
- Elasticiteti i terthorte i kërkeses

### Oferta:


- Elasticiteti i ofertes lidhur me çmimin

## Elasticiteti i kerkeses lidhur me çmimin

- Tregon sasinë e ndryshimit në kerkesën e një malli, kur çmimi i atij malli ndryshon
- Nëse konsumatorët janë shumë të ndjeshëm ndaj ndryshimit të çmimit të produktit, themi se kerkesa është elastike dhe në të kundërt, nëse konsumatorët janë pak të ndjeshëm themi se kerkesa është jo elastike.

## Elasticiteti i kerkeses lidhur me çmimin

- Shembull: Çmimi i kafes rritet nga 1€ në 1.25€



## Elasticiteti i kerkeses lidhur me çmimin

$$\text{Përqindja e ndryshimit të sasisë} = \frac{(q_2 - q_1)}{(q_2 + q_1)/2} \times 100$$

Nga shembulli paraprak:

$$\frac{(70 - 100)}{(70 + 100)/2} \times 100 = \frac{-30}{85} \times 100 = -35\%$$

$$\text{Përqindja e ndryshimit në çmim} = \frac{(p_2 - p_1)}{(p_2 + p_1)/2} \times 100$$

Nga shembulli paraprak:

$$\frac{(1.25 - 1.00)}{(1.25 + 1.00)/2} \times 100 = \frac{0.25}{1.125} \times 100 = 22\%$$

Duhet të llogarisim masën relative të reagimit të konsumatorit, në raport me masën e ndryshimit të çmimit.

## Elasticiteti i kerkeses lidhur me çmimin

Elasticiteti zonal i kerkeses lidhur me çmimin:

$$e_d = \frac{(q_2 - q_1)}{(q_2 + q_1)/2} : \frac{(p_2 - p_1)}{(p_2 + p_1)/2}$$

$$e_d = \frac{\Delta q}{\bar{q}} : \frac{\Delta p}{\bar{p}} = \frac{\Delta q}{\Delta p} \times \frac{\bar{p}}{\bar{q}}$$

Ku kemi:

$$\Delta q = q_2 - q_1$$

$$\Delta p = p_2 - p_1$$

$$\bar{q} = \frac{q_2 + q_1}{2}$$

$$\bar{p} = \frac{p_2 + p_1}{2}$$

$$\text{Shembulli paraprak (grafika a)} = \frac{(95 - 100)}{(1.25 - 1)} \times \frac{(1.25 + 1)/2}{(95 + 100)/2} = \frac{-5}{0.25} \times \frac{1.125}{97.5} = -0.23$$

$$\text{Shembulli paraprak (grafika b)} = \frac{(70 - 100)}{(1.25 - 1)} \times \frac{(1.25 + 1)/2}{(70 + 100)/2} = \frac{-30}{0.25} \times \frac{1.125}{85} = -1.6$$

Kjo mënyrë e llogaritjes përdoret kur ndryshimi në çmim (dhe si rrjedhojë edhe në sasinë kerkuese) është i madh.

## Elasticiteti i kerkeses lidhur me çmimin

Elasticiteti pikesor i kerkeses lidhur me çmimin:

$$e_d = \frac{(q_2 - q_1)}{(q_2 + q_1)} \cdot \frac{(p_2 - p_1)}{(p_2 + p_1)}$$

Ku kemi:  
 $\Delta q = q_2 - q_1$   
 $\Delta p = p_2 - p_1$   
 $p, q$

$$e_d = \frac{\Delta q}{\Delta p} \times \frac{p}{q}$$

Shembulli paraprak (grafika a) =  $\frac{(95-100)}{(1.25-1)} \times \frac{1.00}{100} = \frac{-5}{0.25} \times \frac{1.00}{100} = -0.2$

Shembulli paraprak (grafika b) =  $\frac{(70-100)}{(1.25-1)} \times \frac{1.00}{100} = \frac{-30}{0.25} \times \frac{1.00}{100} = -1.2$

Kjo menyre e llogaritjes perdoret kur ndryshimi ne çmim (dhe si rrjedhoje edhe ne sasine kerkuese) eshte i vogel, ku  $p$  dhe  $q$  perfaqesojne vlerat fillestare te cmimit dhe sasise.

## Edhe nje menyre tjeter....

- $E_p = \frac{\% \Delta \text{Sasia e kerkuar per nje mall}}{\% \Delta \text{ i cmimit te atij malli}}$

## Elasticiteti i kerkeses lidhur me çmimin


- Elasticiteti i kerkeses lidhur me çmimin, ka nje shenje negative, sepse lidhja cmim-sasi eshte nje lidhje e zhdrejte.
- Ekonomistet operojne me vleren absolute te elasticitetit, e cila quhet koeficient i elasticitetit.
- Nese koeficienti eshte:
  - $E_d > 1$  (kerkesa eshte elastike) – reagimi i konsumatoreve ndaj ndryshimeve ne çmim eshte i madh
  - $E_d < 1$  (kerkesa eshte jo-elastike) – reagimi i konsumatoreve ndaj ndryshimeve ne çmim eshte jo i madh
  - $E_d = 1$  (kerkesa eshte unitare) – reagimi i konsumatoreve ndaj ndryshimeve ne çmim eshte i njejt me ndryshimin cmim-sasi

## Elasticiteti i kerkeses lidhur me çmimin

- Nese koeficienti eshte:
  - $E_d > 1$  (kerkesa eshte elastike) – Nje ulje e cmimit do te rrise te ardhurat totale dhe anasjelltas, per nje firme/prodhues.
  - $E_d < 1$  (kerkesa eshte jo-elastike) – Nje ulje e cmimit do te ule te ardhurat totale dhe anasjelltas, per nje firme/prodhues.
  - $E_d = 1$  (kerkesa eshte unitare) – Nje ulje e cmimit do te ndryshoje te ardhurat totale dhe anasjelltas, per nje firme/prodhues.


## Elasticiteti i kerkeses lidhur me çmimin – dy raste ekstreme

Ne kete rast, reagimi i konsumatoreve eshte shume i madh nese nje firm rrite çmimin, sasia e kerkuar bie ne zero. Shembull: firmat ne konkurrence te plote perfekte.



Kerkese plotesisht elastike

Ne kete rast, sasia e kerkuar nuk ndryshon me ndryshimin e cmimit. Konsumatorët nuk reagojnë. Situata te rilla jane te rralla ne realitet. Mund te ekzistoj per nje kohe te shkurter ne monopol.



Kerkese plotesisht jo-elastike

## Faktoret qe percaktojne Elasticitetin e kerkeses lidhur me çmimin

- **Ekzistenca e te mirave zvendesuese** – konsumatorët kanë një shkallë me të lartë reagshmërie ndaj ndryshimit të çmimit në qoftë se mund të zgjedhin mes alternativave tjera. Kërkesa është me elastike kur të mirat kanë zvendësime, dhe jo elastike kur nuk ka zvendësime.
- **Percaktimi i te mires** – numri dhe afërsia e zvendësuesve varet edhe nga fakti se si i percaktojmë të mirat. Kur percaktimi është me i pergjithshem, zvendësuesit do të jenë me të pakët, dhe kërkesa do të jetë me pak elastike.
- **Efkti i te ardhurave** – kur çmimi i një produkti përfaqëson një shumë të madhe në buxhetin/te ardhurat e konsumatorit, atëherë kërkesa e tij/saj është me elastike, dhe e kundërta.
- **Faktori kohe** – për periudha të shkurtra kohore kërkesa ka tendencë të jetë joelastike, ndërsa kur periudha e kohës është e gjatë ajo prirë të jetë elastike.
- **Te mirat e domosdoshme dhe te mirat e luksit** – për të mirat e domosdoshme kërkesa është joelastike, ndërsa për të mirat e luksit kërkesa është elastike.

## Elasticiteti i kerkeses lidhur me te ardhurat

- Elasticiteti i kerkeses lidhur me te ardhurat ( $e_y$ ), mat reagimin e kerkeses ndaj ndryshimit te te ardhurave.

$$\bullet \text{ Formula eshte: } E_y = \frac{(q_2 - q_1)}{(q_2 + q_1)/2} \cdot \frac{(y_2 - y_1)}{(y_2 + y_1)/2}$$

$$\bullet E_y = \frac{\% \Delta \text{Sasia e Kerkuar}}{\% \Delta \text{Te ardhurat e konsumatorit}}$$

- Eshte me rëndësi të ceket se në këtë lloj të elasticitetit, shenja e koeficientit të elasticitetit luan një rol.
  - Nëse koeficienti është negativ (-) – të mirat janë inferiore – pra ulet kërkesa nëse rriten të ardhurat
  - Nëse koeficienti është pozitiv (+) – të mirat janë normale – pra rritet kërkesa nëse rriten të ardhurat

## Elasticiteti i terthorte i kerkeses

- Ky elasticitet mat reagimin e kerkeses se konsumatorit per te miren A, kur kemi nje ndryshim ne çmimin e te mires B, qe eshte e lidhur me te.

Formulat:

$$\bullet E_x = \frac{(q_2 - q_1)_A}{(q_2 + q_1)_A / 2} \cdot \frac{(p_2 - p_1)_B}{(p_2 + p_1)_B / 2}$$

$$\bullet E_x = \frac{\% \Delta \text{Sasia kerkuese per mallin A}}{\% \Delta \text{Cmimin e mallit B}}$$

## Elasticiteti i terthorte i kerkeses

- Shenjat e koeficientit te elasticitetit kane rendesi te madhe.
  - Kur koeficienti i elasticitetit eshte pozitiv, tregon se bleresit do te blejne me shume nga nje e mire, kur cmimi i te mires se lidhur me te rritet. *Pra te mirat jane zavendesuese.*
  - Kur shenja eshte negative, kjo dmth qe bleresit do te blejne me shume nga nje e mire kur cmimi i lidhur me te zvogelohet. *Pra te mirat jane plotesuese.*

## Elasticiteti i ofertes lidhur me çmimin

- Ky Elasticitet tregon reagimin e shitesve ndaj nje ndryshimi ne çmim.
- Kur reagimi eshte i madh, themi qe oferta eshte elastike, dhe nese reagimi eshte i vogel, themi se oferta eshte jo-elastike.

## Elasticiteti i ofertes lidhur me çmimin

$$e_s = \frac{(q_2 - q_1)}{(q_2 + q_1)/2} : \frac{(p_2 - p_1)}{(p_2 + p_1)/2}$$

$$e_s = \frac{\% \Delta \text{Sasia e ofruar per nje mall}}{\% \Delta \text{ i cmimit te atij malli}}$$

- Nese koeficienti eshte:
  - $e_s > 1$  (oferta eshte elastike) – Nje ulje e cmimit do te rrise te ardhurat totale dhe anasjelltas, per nje firme/prodhues.
  - $e_s < 1$  (oferta eshte jo-elastike) – Nje ulje e cmimit do te ule te ardhurat totale dhe anasjelltas, per nje firme/prodhues.
  - $e_s = 1$  (oferta eshte unitare) – Nje ulje e cmimit do te ndryshoje te ardhurat totale dhe anasjelltas, per nje firme/prodhues.

## Faktoret qe percaktojne Elasticitetin e ofertes lidhur me çmimin

- **Kostoja dhe mundesia per depozitim te produktit** – sa me e ulet te jete kostoja e depozitimit dhe sa me i lehte te jete depozitimi, aq me elastike eshte oferta.
- **Fleksibiliteti i procesit te prodhimit** – shpejtësia e pergjigjes me prodhim nga ana e prodhuesve nese cmimi ndryshon
- **Kostoja e prodhimit te njesive shtese** – Kur kosto e prodhimit te nje njesie shtese te jete e larte, ateher oferta eshte jo-elastike, dhe e kunderta.
- **Faktori kohe** – sa me e gjate te jete koha, aq me elastike eshte oferta, dhe anasjelltas.

# Literatura

- Maçellari, Hadëri (2007), "Hyrje në Ekonomi" Pegi Tiranë; Kreu 3, faqe 48-63
- Mankiw & Taylor (2010), "Ekonomiksi" UET-Press UK; Kapitulli 5, faqe 147-176
- Ligjeratat dhe Ushtrimet

# PYETJE???

